



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 16-të e Legjislacionit të VI-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 30.04.2019 (e martë), në sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|---------------------------|-------------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK; | 15. Eliot Kukiqi, AAK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK; | 16. Ardita Idrizaj, AAK; |
| 3. Besa Ferati, LDK; | 17. Jehonë Haxhijaj, AAK; |
| 4. Naim Behlulaj, LDK; | 18. Arben Kabashi, PDK; |
| 5. Luljeta Zeqiraj, LDK; | 19. Ajshe Metaj, PDK; |
| 6. Haki Podrimaj, LDK; | 20. Mirushe Sadikaj, PDK; |
| 7. Selajdin Bytyqi, LDK; | 21. Labinot Alijaj, PDK; |
| 8. Valbona Demaj, LDK; | 22. Agron Avdijaj, VV; |
| 9. Edona Lubeniqi, LDK; | 23. Lavdije Bujupaj, VV; |
| 10. Riza Dreshaj, LDK; | 24. Arif Elshani, IQ; |
| 11. Ruzhdi Metaj, LDK; | 25. Radoš Repanović, SL; |
| 12. Naim Imeraj, AAK; | 26. Radenko Belošević, RB dhe |
| 13. Nexhmedin Balaj, AAK; | 27. Slaviša Maliković, SM. |
| 14. Muhamet Ukaj, AAK; | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në të ishin të pranishëm edhe Kryetari z.Haki Rugova, drejtorë të drejtorive të komunës, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe në CD-të e xhirimit, të cilat gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit, z. Qaush Balaj. Kryesuesi përshëndeti, kryetarin, anëtarët e kuvendit, përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, drejtorët e drejtorive dhe të pranishmit tjerë në mbledhjen e 16-të e Legjislacionit të VI-të. Për këtë mbledhje propozon këtë rend dite si dhe bën hapjen e seancës së kuvendit të komunës.

Rendi i ditës

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shpallja dhe miratimi i Propozim-Vendimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen qytetar nderi të Gjeneral Major z. Timothy Orr - agjutant i përgjithshëm i gardës nacionale në IOWA (Ajova);
4. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e parë (Janar - Mars) të vitit fiskal 2019-të;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i destinimit të mjeteve të bartura nga viti 2017-2018 në vitin 2019-të;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit Zhvillimor Komunal (PZHK);
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e rrugës në njësitë kadastrale Nr: 714/4, 714/6, 714/7, 715/8 në Planin Strategjik Urban të Komunës;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i rishqyrtimit të Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Komunale për ndarjen e bursave;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i rishqyrtimit të Rregullores për hapjen e Kutive të Ankesave në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Istogut;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-Vendimit të Kryetarit të Komunës për formimin e komuniteteve konsultative:
 - a) Komiteti konsultativ për Arsim
 - b) Komiteti konsultativ për Shëndetësi dhe
 - c) Komiteti konsultativ për Shërbime Publike;
12. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi- hap mbledhjen dhe pyet nëse ka diçka dikush për këtë rend dite? Fjalën e ka kërkuar Kryetari i Komunës.

Kryetari- përshëndeti anëtarët e kuvendit, mysafirët, në veçanti z. Xhavit Gashi, Konsullin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe propozon që të hiqet pika numër 6 (Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit Zhvillimor Komunal - PZHK) nga rendi i ditës, pasi që nuk është siguruar akoma miratimi nga ministria përkatëse e Planifikimit Hapësinor dhe për shkak të

disa procedurave që kanë të bëjnë me çështje të brendshme dhe propozon që kjo pikë të hiqet nga shqyrtimi në këtë seancë.

Kryesuesi- falënderon kryetarin, hedh në votim propozimin e Kryetarit që kjo pikë të shtyhet për shkaqet e lartcekura dhe të mbetet për tu shqyrtuar në seancat tjera.

Të gjithë anëtarët e kuvendit votuan unanimisht që kjo pikë të shtyhet për seanca tjera.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë tre anëtarë të kuvendit, Naim Behlulaj, Ardita Idrizaj dhe Jehonë Haxhijaj.

Shqyrtimi i pikës 1

Kryesuesi- i uron mirëseardhje konsullit Gashi në këtë seancë të Kuvendit të Komunës dhe vazhdon me pikën e parë të rendit të ditës, arsyetimi i mungesave në mbledhje. Deklaron se vetëm Naim Behlulaj e ka njoftuar paraprakisht për mosardhjen, kurse dy anëtarët tjera Ardita Idrizaj dhe Jehonë Haxhijaj nuk kanë dërguar ndonjë njoftim eventual për mungesë në këtë seancë

Shqyrtimi i pikës 2

Kryesuesi- edhe pse mungojnë dy anëtarë të kuvendit dhe në seancë janë të pranishëm 25 anëtarë është kuorumi për të proceduar në këtë seancë dhe menjëherë kalohet në pikën e dytë, miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi pyet anëtarët e kuvendit se a kanë diçka për të shtuar rreth procesverbalit ku asnjë nga anëtarët nuk u paraqit të marrë fjalën dhe këtë e hedh në votim.

Kuvendi me votim unanim, pa asnjë votë kundër dhe pa abstenime miratoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë tre anëtarë të kuvendit, Naim Behlulaj, Ardita Idrizaj dhe Jehonë Haxhijaj.

Shqyrtimi i pikës 3

Kryesuesi- vazhdon me pikën e tretë, Shqyrtimi dhe Miratimi i Propozim-Vendimit të kryetarit të Komunës për shpalljen qytetar nderi, Gjeneral Majorit z. Timothy Orr - agjutant i përgjithshëm i gardës nacionale në IOWA (Ajova), lidhur me këtë pikë fjalën ia kalon , Kryetarit të Komunës.

Kryetari- falënderon kryesuesin. Iu drejtohet anëtarëve të kuvendit lidhur me propozimin për shpalljen qytetar nderi të Gjeneral Major z. Timothy Orr i cili ishte mjaft entuziast dhe i vullnetit të mirë që të na nderojë neve dhe veten në këtë moment të shpalljes dhe marrjes së çmimit nga Komuna e Istogut si qytetar nderi i saj dhe shpreson që Kuvendi Komunal këtë propozim do e miratojë dhe deklaron se me 08.05.2019 në kuvend do të jetë i pranishëm Gjeneral Major z. Timothy Orr dhe

do të marrë personalisht këtë çmim në një seancë solemne dhe ky do të jetë angazhim i mëtejshëm i Gjeneralit për Komunën e Istogut si ndihmë në procedurat që veç se kanë filluar të binjakëzimit të komunës sonë me një ndër komunat e shtetit të Iowas. Bartës i këtyre proceseve do jetë edhe qeveria e Kosovës, ministria përkatëse në bashkëpunim me konsullin e Kosovës z. Xhavit Gashin, i cili është prezent. Ju si anëtarë të kuvendit e keni një përmbajtje të biografisë së punës dhe angazhimit të gjeneralit dhe propozoi që kjo të lexohet por paraprakisht fjalën ia kaloi z. Xhavit Gashit, që të jep informacion për të, i cili disa herë ka qenë për vizitë në Kosovë dhe gjithherë është angazhuar për çështjen e Kosovës, në veçanti ushtrinë e saj.

Kryesuesi- fjalën ia kalon z. Xhavit Gashi, Konsullin e Përgjithshëm të Republikës së Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Xhavit Gashi- falënderon kryetarin, kryesuesin, anëtarët e kuvendit dhe drejtorët. I përshëndet të pranishmit posaçërisht Kryetarin për mbështetjen e ofruar në shpalljen qytetar nderi të Gjeneralit Orr. Paraqet një përmbledhje të shkurtër lidhur me historikun e njohjes me Gjeneralin Orr e deri në momentin kur ia e ka pranuar këtë nder dhe ai jo vetëm që do të pranojë këtë titull por të vazhdojë të jetë pjesë e kontributit për Istogun dhe Kosovën. I falënderon të gjithë për mundësinë e dhënë dhe për mbështetjen.

Kryesuesi- falënderon z. Xhavit Gashin dhe pyet anëtarët e kuvendit nëse dëshiron dikush të marr fjalën, ku e kërkon anëtari i kuvendit Zenel Shatri pastaj Arif Elshani.

Zenel Shatri- Përshëndet kryetarin, kryesuesin , të gjithë të pranishmit , posaçërisht Gjeneralin Xhavit Gashi. Kemi nderin që ne të shpallim si qytetar nderi të Komunës së Istogut Gjeneralin Orr kështu që mendoj se është nder sepse kontributi i tij në të ardhmen siç tha edhe gjenerali do të jetë shumë i madh kështu që mendoj që është shumë i qëlluar .

Kryesuesi, falënderon Zenel Shatrin dhe fjalën ia kalon Arif Elshanit

Arif Elshani- falënderon kryesuesin dhe përshëndet të gjithë dhe veçanti z. Gashi. Deklaron se është një nder që komuna jonë shpall një gjeneral qytetar nderi dhe ky është rasti i dytë që në këtë mandat ne si kuvend komunal shpallim qytetar nderi , ku më herët kishim shpallur një gjerman. Dua të organizojmë këtë shpallje qytetar nderi kur të jetë prezent edhe vet gjenerali, pasi që ai është një nder edhe për ne dhe për të. E kishim një rast me gjermanin i cili u shpall qytetar nderi, na premtua që do të vjen dhe unë nuk e di a erdh apo nuk erdh. Që të shpallet një person qytetar nderi mendoj që ai duhet të jetë prezent ose mbledhja të shtyhet për datën 8 maj kur gjenerali të jete prezent dhe të merr atë titull.

Kryesuesi- e falënderon Arif Elshanin, i drejtohet Kryetarit se a keni sqarime rreth kësaj.

Kryetari- me datën 8 kur gjenerali do të jetë këtu prezent do të thirret një seancë solemne e asamblesë komunale kur do të jepet çmimi në menyrë solmne ceremoniale, kjo është procedura që duhet të bëhet ndërsa në momentin e marrjes së vendimit prezenca e të nominuarit nuk është e domosdoshme. Nuk janë këto praktika. Ndërsa te rasti i dhënies së çmimit- marrjes së vendimit për gjermanin z. Bajer që është anëtar i Bundestagut i parlamentit të Evropës , ai do të vjen në momentin e caktuar, e ka marr vendimin me shkrim të miratuar nga kjo asamble komunale dhe ka premtuar që në një datë të caktuar kur ai konsideron në marrëveshje që është moment i duhur ai do të jetë prezent këtu në një seance solemne ku do të merr çmimin, kjo është e tëra nuk ka ndonjë arsye tjetër.

Kryesuesi- falënderon kryetarin dhe pyet anëtarët e kuvendit nëse dëshiron dikush të marr fjalën të cilën e kërkon Naim Imeraj.

Naim Imeraj- faleminderit për fjalën kryesues, përshëndetje për të gjithë pranishmit posaçërisht për Gjeneral Gashin. Sot si anëtar i kuvendit të komunës jo vetëm unë por besoj të gjithë kolegët këtu jemi krenarë që po hapojmë në dy drejtime, një së paku në drejtimin e parë është që po bëjmë edhe një mik duke shpallur. Një person të fuqishëm së paku nga ajo çka shihet nga biografia e tij personale, një personalitet të fuqishëm të SHBA-së po të njëjtën kohë krenaria është edhe më e fuqishme që këtu e kemi në mesin tonë një djal i cili ka kontribuar, i kërkoj falje që po i drejtohem me ekselence me "djalë ", që ka kontribuar në të gjitha periudhat e shtetndertimit të shtetit tonë. Në këtë drejtim veç desha të shpreh këtë krenari edhe pa dyshim që sot po bëjmë një hap të mirë që rezultatet e të cilit do të shihen në të ardhmen, faleminderit kryesues.

Kryesuesi- faleminderit i nderuari Naim. Dikush tjetër e dëshiron të marr fjalën. Nuk e kërkon askush. Kryesuesi shprehet se unë jam i bindur që do të jemi unik në këtë vendim megjithatë duhet të votojmë prandaj pyes anëtarët e kuvendit, kush është që të miratohet propozim- vendimi i kryetarit te komunës ?

Kuvendi me votim unanim, pa asnjë votë kundër dhe 3 abstenime miratoi propozim-vendimin e Kryetarit të Komunës për shpalljen qytetar nderi të Gjeneral Major Timaty Orr, agjutant i përgjithshëm i gardës ne Iowa. Në procedurën e votimit nuk morën pjesë dy anëtare të kuvendit, Ardita Idrizaj dhe Jehonë Haxhijaj.

Kryesuesi- pas votimit fjalën ia kalon kryetarit.

Kryetari- iu falënderoj për këtë votim të propozimit tim, të jeni të bindur që më nderuat mua personalisht si kryetar komune dhe Xhavit Gashin si iniciator dhe qeverinë që është në ngjarje. Është një nder i madh për miqtë tanë, gjeneralin i cili po sa u shpall qytetar nderi, faleminderit edhe njëherë juve që jeni prezent, sidomos ju që e morët vendimin në mënyrë unanime .

Kryesuesi- falënderon kryetarin, Gjeneralin Xhavit Gashi për pjesëmarrjen me shpresën se me 8 maj do ti shihemi në seancën solemne të kuvendit.

Shqyrtimi i pikës 4

Kryesuesi - vazhdon procedimin me këtë pikë sipas rendit të ditës, përkatësisht, pikës 4- Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e parë (Janar – Mars) të vitit fiskal 2019-të, lidhur me këtë fjalën ia kalon Zyrtarit Kryesor Financiar, Osman Sadikaj .

Osman Sadikaj- përshëndet të pranishmit dhe prezanton raportin financiar për tremujorin e parë (Janar – Mars) të vitit fiskal 2019-të për Komunën e Istogut.

Kryesuesi- falënderon Osman Sadikajn dhe pyet anëtarët e kuvendit nëse ka dikush pyetje nga kjo pikë? Fjalën e ka kërkuar Eliot Kukiqi dhe Arben Kabashi.

Eliot Kukiqi- përshëndet të pranishmit. Gjatë analizës së raportit të cilën e ceku edhe zyrtari kryesor financiar, nga burimet e financimit kemi 9 milion e 306 mijë e 242 euro, financimi nga huamarrjet 94 mijë e 294 euro, financimi nga marrja e klauzës së investimeve 5 milion e 94 mijë e 246 euro, të hyra vetanake 1 milion e 277 mijë e 578 euro, granti donator i brendshëm 14 mijë e 307 euro, qeveria zvicerane 165 mijë e 409 euro, totali i buxhetit 15 milion 952 mijë e 161 euro. Nëse i analizojmë shpenzimet në këtë tre mujorin e parë të vitit 2019, mund të shihet se nga buxheti janë shpenzuar 1 milion e 624 mijë e 659 euro ose në përqindje 17.46 % . Për investime kapitale është shpenzuar vetëm një projekt në vlerë prej 4869 euro. Gjatë kësaj analize atë që e vërejta lidhur me shpenzimet për riparimin e automjeteve ku për tremujorin e parë janë shpenzuar 6 mijë e 671 euro, e cila shumë më duket shumë e lartë dhe nëse kjo përpjesëtohet me ditë pune i bie që në një dite pune janë shpenzuar 102 euro vetëm për riparimin e automjeteve. Të hyrat vetanake janë të realizuara në 16.6% e cila nuk është e kënaqshme dhe nëse vazhdohet me këtë trend në muajt në vazhdim atëherë nuk do ta arrijmë as 70 %-shin e planifikuar, ju faleminderit.

Kryesuesi- falënderon Eliot Kukiqin dhe fjalën ia kalon Arben Kabashit

Arben Kabashi- falënderon kryesuesin, përshëndet të pranishmit. Sa i përket krahasimeve nuk dua të bëj të këtij tre mujori me tre mujorin e vitit të kaluar por

pyetja ime është, në këtë tre mujor a ka bartje të projekteve të reja sepse janë diku 5 projekte të reja në shumat prej 30 mijë euro, 90 mijë euro, prapë 30 mijë euro, pra a janë projekte të reja që janë bartë prej viteve të kaluara, te paplanifikuara apo te planifikuara.

Kryesuesi- falënderon Arben Kabashin dhe fjalën ia kalon Osman Sadikajt.

Osman Sadikaj- i drejtohet Arben Kabashit me sqarim, që është pikë e veçantë e shqyrtimit pasi të kaloi kjo pikë e cila është duke u diskutuar tash. Nuk është burim i financimit bartja e shumës prej 566 mijë euro, tash do të jetë pikë e veçantë e rendit të ditës, ju faleminderit.

Kryesuesi- iu drejtohet anëtarëve të kuvendit nëse kanë ndonjë pyetje, askush nuk e kërkon fjalën. Është një pikë që diskutohet çdo tre muaj, nuk kemi nevojë ta votojmë.

Shqyrtimi i pikës 5

Kryesuesi- vazhdon me pikën e 5-të të rendit të ditës, përkatësisht Shqyrtimi dhe miratimi i destinimit të mjeteve të bartura nga viti 2017-2018 në vitin 2019-të dhe për këtë fjalën ia kalon fillimisht Kryetarit e pastaj Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Hysni Maxharraj.

Kryetari- besoj që e keni marr me shkrim propozimin, ky propozim është diskutuar në takimin e KPF-së dhe prej aty ka ardhur këtu në këtë seancë të kuvendit. Për më tepër sqarime rreth këtij propozimi do të jep Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Hysni Maxharraj.

Kryesuesi- falënderon Kryetarin dhe ia kalon fjalën Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Hysni Maxharraj.

Hysni Maxharraj- falënderon kryesuesin, përshëndet të pranishmit dhe bën prezantimin e shqyrtimit dhe miratimit të destinimit të mjeteve të bartuara nga viti 2017-2018 në vitin 2019-të.

Kryesuesi – falënderon Hysni Maxharrijan për prezantimin. Iu drejtohet anëtarëve të kuvendit nëse do dikush të marr fjalën, është lajmëruar Arben Kabashi dhe Agron Avdijaj.

Arben Kabashi – më herët e kisha fjalën për projektet e reja dhe sipas një analize të thjeshtë po del që mund të kemi projekte të reja, çdo anëtar i kuvendit paska mundësi të propozojë projekte të reja, pra, projekte kapitale që këtë shumë prej 566 mijë euro që po bartet nga viti 2017 prej burimeve të financimit, pra, prej të hyrave

vetanake deri në vitin 2019. Si shembull marrim memorialin " Ibrahim Rugova " ku më herët nuk ka qenë e planifikuar ndërtimi i shtatores tash diskutohet kjo si një projekt i ri, pra ngritjen e shtatores së ish Presidentit në atë memorial e cila nuk ka qenë e planifikuar në projektin e parë kurse tash kemi ngritje të punimeve artistike për ish kryetarin e komunës, ngritjen e lapidarit të " sheshi i gjakut ". Janë shumë projekte të parealizuara shembull marrim shkaku i mosbetonimit të kanalit të ujitjes apo faktin që Istogu nuk ka shesh, thjesht mos është duke u investuar në diçka ku qytetari nuk e vëren zhvillimin dhe rahatën që mund të punësohet në të ardhmen, po investohet në shuma të mëdha në diçka që nuk është prioritare. Dhënia e 90 mijë eurove për shtatoren e ish presidentit i bie që projekti i memorialit " Ibrahim Rugova " ka dështuar totalisht dhe nëse duam të japim propozime të reja për projekte unë po e ofroj një tillë. Në Gurrakoc prej edhe nga vi, mungon betonimi i kanalit të ujitjes nga i cili varet vaditja e qindra hektarë tokë të cilat mbesim pa u vaditë shkaku i atij mos betonimi të kanalit. Komuna edhe në vitet e kaluara ka premtuar për betonimin e tij gjë që nuk ka ndodh akoma dhe taksat e qytetarëve po i orientojmë në diçka që nuk shoh zhvillim në to, diçka që nuk është e momentit, jam për këto projekte por jo në këtë moment sepse jemi në një kohë krize. Janë 150 mijë euro taksa po shkojnë në diçka që nuk shihet zhvillim dhe këtu e kam vërejtjen unë. Memoriali " Ibrahim Rugova " ka kushtuar deri në 800 mijë euro që po i bie 400 mijë janë nga taksat e qytetarëve, krahasuar me grantet qeveritare që i ka ofruar qeveria si ndihmë. Ndërtimi i shtatores, një projekt ekstra i ri në shumën prej 90 mijë euro, punimi i pllakës artistike për ish kryetarin 20 mijë euro do të thotë iu kanë shtuar edhe 10 mijë euro pasi që kanë qenë të planifikuara 20 mijë dhe tash janë shtuar edhe 10 mijë do të thotë në total 30 mijë euro. Taksat e qytetarëve nuk po i orientojmë në zhvillim.

Kryesuesi- falënderon Arben Kabashin dhe fjalën ia kalon Agron Avdijajt.

Agron Avdijaj- falënderon kryesuesin, përshëndet të pranishmit. Hap diskutimin lidhur me vendimin e marrë nga ana e kuvendit të komunës përme subvencionimin e stacionit të autobusëve por pavarësisht kësaj si duket ende nuk janë gjetur mjetet apo nuk po dihet ku është pengesa dhe gjendja aty po vazhdon të keqësohet gjithherë e më shumë. Borxhet janë rritur, a ka mundësi ligjore të bëhet diçka për tu përmirësuar gjendja aty. Pasi që është marr vendimi të shqyrtohet mundësia e ndarjes së ndonjë subvencionit të caktuar, pastaj të caktohet një lloj auditimi dhe të shikohen mundësitë për të dal nga kjo gjendje e cila gjithherë e më shumë po dramatizohet. Nuk e di edhe për projektin që është premtuar nga ana e kryetarit për rrugën të zona industriale, ku besoj që edhe bizneset kanë bërë kërkesë dhe që është biseduar me ta. Do të kishte qenë mirë të shikohet mundësia e ndonjë projekti për rrugë atje sepse është shumë e nevojshme. Sa herë aty ka reshje më të mëdha të shiut paraqitet rreziku për aksidente të mundshme dhe bizneset intervenojnë për sajimin

e asaj gjendje të krijuar. Është në të mirë të komunës të investohet në atë rrugë deri sa komuna atë pjesë e ka ndarë si zonë industriale, t'i krijoj edhe kushtet infrastrukturore atje. Faleminderit.

Kryesuesi- falënderon Agron Avdijajn dhe fjalën ia kalon Arif Elshanit.

Arif Elshani- falënderon kryesuesin. Mendoj që mjetet në shumën prej 500 mijë euro çdo herë gjendet arsyeja se ka shkuar gjithçka mirë apo keq por ka edhe arsye tjera që kanë mundur ndoshta të përdoren edhe në një metodë më të mirë. Komuna ka pasur vende që kryetari së bashku me ekzekutivin të mendojnë a mos ka ndonjë prioritet që shkon për të mirën e gjithë qytetarëve. Që 5 vite po flitet për memorialin " Ibrahim Rugova ", që 5 vite po investohet aty dhe assesi nuk po përfundohet. Përveç shtatores në shumën prej 90 mijë euro dhe 40 mijë euro tash të shtohen kam një pyetje për kryetarin, a përfundon me kaq ai projekt edhe sa mjete duhet të investohen në të. Unë mendoj se aty është shpenzuar shumë dhe fundi i saj nuk dihet ku del, ideja ime është ndoshta kishte me qenë më mirë në ndonjë mbledhje të na jepet arsyetim, sa mjete të komunës janë harxhuar, sa të granteve qeveritare dhe a përfundon ndonjë ditë ai projekt duke e pa se tash duhet të shtohen edhe 130 mijë euro ashtu siç dëgjova. E foli edhe Agroni, rastin e shpëtimit të stacionit të autobusëve dhe ndoshta do të kishte qenë më mirë që nga ato 500 mijë euro disa prej tyre të dedikohen për stacionin e autobusëve. Zgjidhja nuk mund të bëhet duke heshtur, aty duhet të bëhet një zgjidhje, se ajo është pronë e komunës e cila as nuk mund të shitet, as nuk mund të prishet dhe është momenti i duhur të merret një vendim lidhur me stacionin e autobusëve. Sa i përket projekteve tjera që kanë nevojë qytetarët nuk kam çka e diskutoj sepse shumë çka i kam përmendur që 5 vite dhe ky është viti i 6-të kur po diskutoj për ndarjet buxhetore dhe bartjet e mjeteve , unë mendoj në mënyrën më të qëlluar. Faleminderit.

Kryesuesi - falënderon Arif Elshanin dhe fjalën ia kalon Labinot Alijajt

Labinot Alijaj - falënderon kryesuesin, përshëndet të pranishmit. Deklaron se desha të ndërlihem me këto dy projekte të cilat i përmendi Arbeni dhe unë e shoh të arsyeshme që në vend të lapidarit të presidentit Rugova dhe lapidarit të " sheshi i gjakut " të cilat e arrijnë shumë prej 120 mijë euro, atëherë të marrim rrugën " Ibrahim Rugova " - ish korzën e vjetër dhe ta kthejmë në shesh nëse me të vërtetë aq shumë e duam presidentin Rugova atëherë aty të ndërtohet shesh në të cilin kishte pas mundësi të vendosej edhe punimi artistik për ish kryetarin e ndjerë Fadil Ferati. Më herët janë ndarë 20 mijë euro tash paska ngritje në 30 mijë euro, e kemi familjen Shatri që janë duke pritur vendimin që t'i caktohet një vend për vendosjen e lapidarit për dëshmorin Izet Shatri dhe nuk kanë marr akoma një përgjigje që nga viti i kaluar dhe ta keni në konsideratë këtë. Fondet për ngritjen e lapidarit për ish presidentin Rugova dhe "sheshin e gjakut", që janë 120 mijë euro të kthehen në një projekt tjetër për përfundimin e një sheshi në komunën tonë, që është rruga " Ibrahim Rugova " pra ta kubëzojmë dhe ta kthejmë në shesh atë pjesë. Faleminderit.

Kryesuesi- falënderon Labinot Aliajn dhe fjalën ia kalon Kryetarit për replikë

Kryetari - disa i mora si vërejtje, disa si sugjerime por nga ajo që deklaruat nuk kishte pyetje dhe kishte paqartësi por unë do të bëj përpjekje t'ua prezantojë ku janë paqartësitë dhe po e shoh që ka mungesë të informacionit. Arbenit fillimisht dua t'i përgjigjem në atë që tha se memoriali Ibrahim Rugova është dështim total. Ai projekt nuk është dështim dhe shtatorja mos të merret si pjesë e memorialit, si pjesë e projektit, kjo është diçka krejt tjetër dhe memoriali është në përfundim dhe punët janë duke u kryer me intensitet. Propozimi për shtatore nuk ka dal në kohën e duhur për një arsye të vetme është prolonguar gjithë kohën dhe tash është gjet momenti më i volitshëm të vendoset dhe nuk pajtohem me atë se kjo është pjesë e projektit të memorialit. Këto projekte pikërisht kanë karakterin zhvillimor deri sa ne iu kemi dhënë prioritet projekteve zhvillimore. Istogu ka prioritet në fazën që na pret zhvillimimi i pjesëve urbane sidomos qendra e Istogut, në mënyrë më intensive. U përmend sheshi poshtë i cili është në projekt, do të fillojë procedura dhe sipas kësaj kemi rruga e Istogut prej "sheshit të gjakut", rruga "Fadil Ferati" dhe rruga "Ibrahim Rugova" në një projekt 2 vjeçar që pritet të filloi tash. Jemi në procedurën e hartimit të projekteve dhe do të bëhet investim gjeneral, hapja e rrugës, kanalizimi, ujësjellësi, ndriçimi dhe të gjitha komponentët tjerë që përfshihen në projekt së bashku me parkun e qytetit. Herën e fundit është marrë vendim për sipërfaqen në qendër të Istogut. Largimi i objekteve që janë aty, janë në procedurë, do të presim vendimin e qeverisë deri sa të procedohet atje ajo, ky është realizimi i planeve të projekteve zhvillimore që i ka qendra urbane, pjesa urbane e Istogut. "Sheshi i gjakut" do të jetë një shesh që do të ketë një simbol për të cilin mendoj se është tepër e rëndësishme, vendosja e një memoriali apo lapidari, ajo është një ide tash që do të zhvillohet dhe të jetë si dëshmi që ka pas aty persekutime në të gjitha periudhat, jo vetëm në periudhën e fundit dhe se është bërë përpjekje për liri dhe çlirim edhe në faza më të hershme. Ta kemi edhe një shenjë për kryetarin e parë në Istog, në demokraci, në periudhën më të re për z. Fadil Feratin. Një simbol, një shenjë përkujtuese para hapësirës apo brenda saj ta quaj të kësaj zone të Komunës së Istogut dhe në qendër është shtatorja e presidentit Rugova. Mendoj që Istogu duhet t'i ketë këto tri pika të hyrjes, pastaj do të merren edhe vendimet tjera shembull tjetër te parku spanjoll do të jetë një pikë dhe këto do të ndikojnë dhe kjo do të jetë krenari për Istogun. Këto pika të jenë të vizitueshme, në qendër do të jetë muzeu, do të jenë edhe shumë vende që vlen të vizitohen, duke filluar edhe me karakterin e projekteve turistike zhvillimore që jemi duke i zhvilluar në tërë territorin e Komunës së Istogut. Lidhur me idenë e Agronit, do të gjejmë forma dhe nuk do të braktisim stacionin e autobusëve, do ta përkrahim atë ndërmarrje sepse vet e kemi themeluar si të tillë, ka shumë vështirësi dhe e kemi pritur një gjë të tillë mirëpo ne kërkojmë më shumë angazhim që ata gradualisht të krijojnë të hyrat e veta vetanake në mënyrë që të mbijetojë ajo ndërmarrje, ne do ta përkrahim gjithsesi. E di që ka plot ide, ka plot rrugë, ka plot projekte por mos të harrojmë edhe një gjë, tash automatikisht do të fillojë faza e re, planifikimet buxhetore për vitin e ardhshëm dhe do të ketë

diskutime publike, do të ketë edhe diskutime këtu, besoj edhe po shpresoj që do të ketë edhe rishikim të buxhetit, këto do t'i shohim në fazën e ardhshme dhe ato projekte të kanaleve të ujitjes që janë projekte tjera që nuk janë të braktisura dhe janë në listë, disa prej tyre në listë të projekteve. Është një dinamikë e realizimit të këtyre projekteve dhe assesi nuk mund ta pranoj konstatimin që memoriali në qendër të Istogut është deshtim, përkundrazi e di që ka pasur vonesa edhe të jeni të sigurt të gjitha shpenzimet dhe të gjitha procedurat që janë zhvilluar aty, mund të keni qasje kur të doni edhe kur të doni ne do të raportojmë, ne kemi raportuar në instanca që duhet të raportohet, çdo gje aty është transparente, aty më shume është spekuluar, aty çdo gjë është korrekte. Aty ku nuk ka funksionuar, kompanitë që kanë filluar një fazë janë ndeshkuar, janë larguar, është dashur të përsëriten të gjitha procedurat dhe tash jemi në finalizim, unë mendoj që deri ne vendosjen e shtatores d.m.th. deri ne fund të këtij qershori sa di unë edhe kontrata është e tillë dhe se ajo kontratë duhet të përfundojë, punët veç se janë duke u zhvilluar. Këto janë diskutuar edhe ne komitetin për politikë dhe financa, propozimet janë aprovuar aty, tash është para juve, unë e di që ka plot propozime të reja prej juve, mendoj që propozimet e reja do të na sjellin në telashe të mundshme. Këtu janë dhënë vlerat dhe unë nuk e besoj që aty kanë me u shpenzu 90 mijë euro, jam i sigurt që ka me pas tepriçë të mjeteve, të cilat janë në menaxhim të ardhshëm dhe konsiderohen si mjete të bartura, hyjnë në buxhet, kjo është ideja, aty do të shpallet një konkurs ligjor, në konkurrencë njerëz ekspert qoftë arkitekt apo skulptor të cilët merren me këto veprimtari, do të bëhet një komision i posaçëm që do të bëjë vlefshmërinë sipas procedurave ligjore, do të jem mirënjohës nëse ju do të përkrahni si kuvend komunal sepse e di që ka plot propozime tjera. E kam pa si moment të volitshëm me i përfshi këto tri pika që janë diskutuar e janë fol dhe asnjehere nuk kanë dal përveç këtij të Fadil feratit që kanë qenë propozime të mëhershme dhe është momenti që të trijat t'i fusim në një fazë, në një procedure, ashtu siç edhe duhet me i pas, ju faleminderit.

Kryesuesi- falënderon kryetarin. Fjalën e ka kërkuar Naim Imeraj, Arben Kabashi dhe Arif Elshani.

Arben Kabashi- sa për sqarim kryetar, janë tema të ndjeshme. Këto janë projekte të reja. Punimi artistik për ish kryetarin e komunës, mirë që po diskutohet ngritja e një pllake përkujtimore, domosdo edhe vet kisha financuar privatisht për një pllakë artistike, të jemi të qartë, të bëjmë dallimin sepse ju po i quani të trijat projekte zhvillimore, këto nuk janë projekte zhvillimore, mund t'i quani si të tilla por realisht nuk janë. Shtatorja, jemi të gjithë për por është jashtë projektit të memorialit. Në memorial kur ka qenë i planifikuar në fillim nuk ka qenë shtatorja dhe nuk jam kundër asnjë punimi artistik qoftë për lapidarin te sheshi i gjakut apo shtatoren e Ibrahim Rugovës vetëm të kemi të qartë se këto nuk janë projekteve zhvillimore, për shkak se kemi projekte tjera me të cilat çdo ditë qytetarët ballafaqohen me to, mos të përmendi një rast të një familje që janë në skamje, që kanë bërë kërkesë që 3 a 4 vjet për ndërtimin e shtëpisë e që janë duke jetuar me 6 fëmijë ose betonimi i kanalit ku

qindra hektarë janë pa ujitje për shkak të mungesës së një betonimi i cili nuk bëhet, tash a janë ato zhvillimore apo këto zhvillimore, të bëjmë dallimin.

Kryesuesi- fjalën ia kalon Kryetarit për replikë pas përfundimit të fjalës nga ana e Arbenit.

Kryetari- unë jam shumë i lumtur që po thua se është mendimi yt personal dhe jam i lumtur që ky mendim nuk është edhe mendim kolektiv, ky është edhe fat edhe me atë konstatimin tënd që nuk janë pjese e projekteve zhvillimore, unë nuk pajtohem.

Kryesuesi- falënderon kryetarin edhe Arbeni është që këto projekte të jenë, diçka tjetër është pyetja a janë çfarë janë dhe fjalën ia kalon Naim Imerajt.

Naim Imeraj- falënderon kryesuesin për fjalën. Tash edhe unë po flas si individ. Në rrethana të caktuara nëse përmbajtja e këtij propozimi për ridestitim të mjeteve të bartura, jo veç nga viti 2017 por edhe nga viti 2016 dhe 2015 sepse ajo ka shkuar në menyrë retoraktive, para ose prapavepruese. Nëse nuk do të ishte komponentja kulturoro-historike për mua përmbajtja e këtij propozimi është zhgënjyese. Elementi që u fol e përfol i projekteve që kanë karakter kulturor-historik, që i bëjnë nder komunës së Istogut e besoj që kështu si unë ndihen edhe qytetarët tjerë të Komunës së Istogut pavarësisht si e artikulojnë atë ndjesi të veten na bën që me pas rezerva në raport me atë se a e meriton ky propozim të kalojë, por besoj që debati nuk i bën keq demokracisë me kusht që mos të jetë me teke. Do t'jem shumë i lumtur kur të shoh të përfunduar edhe memorialin edhe shtatoren edhe sheshin e gjakut dhe besoj që këtë ndjesi do ta kenë të gjithë qytetarët e komunës së Istogut. Foljet dhe përfoljet kanë kaluar edhe nëpër faza tjera që kanë qenë të dhimbshme deri në nivele të hetuesisë dhe shpresoj e jam i bindur duke qenë një lloj institucionalisti që organet e kanë bërë punën e vet dhe në ato rezultate nuk dyshoj kurr pavarësisht në rrjedhat dhe rrethanat shoqërore në të cilat jemi duke jetuar. Bartja e një vlere të tillë prej gati 600 mijë eurove nuk besoj që jep mesazh të mirë për planifikimet paraprake që i kemi bërë, personalisht nuk e kam fsheh por e kam shpreh në vazhdimësi për kontributet e mia në raporte periodike financiare që po bëhen me qëllim. Nëse qëllimi ka qenë ky ta realizojmë, ta përkufizojmë një dukje, një shpërfaqje para qytetarëve të komunës së Istogut fillimisht pastaj edhe para tjerëve që janë të përditshëm si vizitorë, si turistë, si familjarë në Komunën e Istogut atëherë hallall i qoftë edhe atyre projekteve që kanë ngapak jo ngapak por bukur shumë hile në krijimin e prioriteteve në atë listë, besoj që janë shumë i qartë, nuk po dua me thënë më shumë, po na ndodhin gjëra që prioritetet duhet t'i analizojnë vet, të jenë vetëdijshëm, po kaloj prej temës por është brenda teme sepse po flasim për ridestitim të mjeteve se po na ndodh iu shkojnë restoranteve deri te dera me kilometra rrugë, objekteve të caktuara të cilat ndoshta janë të kontestueshme edhe në elementë pronësore, në momentet e fundit të fundvitit dhe në pjese tjera të qytetit të Istogut, të pjesës së vjetër të qytetit të Istogut, duhet pak të rezunoni, duhet të rezunojmë përgjithësisht si kuvend dhe të kemi pak parasysh që jo gjithmonë

prioritetet bëhen për atë që unë e kam thënë për një ditë. Prapë po e them nuk do ishte mirë të punohet 1 ditë për 4 vite, besoj që jam shumë i qartë, kryesues faleminderit për mundësinë.

Kryesuesi- falënderon Naim Imerajn për fjalën dhe fjalën ia kërkon Arif Elshani.

Arif Elshani- falënderon kryesuesin. Ne të gjithë jemi që të ngritën këto memoriale, këto shtatore, këto monumente që me të vërtetë popullin tonë e kanë prekur. Asnjëherë nuk kam qenë kundër as nuk do të jem por përveç këtyre memorialëve dhe shtatoreve mendoj që edhe një veprimtari të devotshëm i cili nuk është në partinë time, është në partinë e juaj, Shaban Manaj, është deshur të mendohet sepse ka pas një meritë dhe respekt për atë person që të vendoset për të një shtatore apo një shenjë në komunën e Istogut pasi që ka qenë një veprimtar i devotshëm dhe asnjëherë nuk kam dëgjuar që është marr ndonjë vendim por sidoqoftë kjo i mbetet kryetarit dhe ekzekutivit të mendojë. Mendoj që ish dashtë ose edhe sot duhet që t'i gjendet një vend edhe Shaban Manajt, të vendoset një shenjë në qendrën e Istogut. Sa i përket politikës për memorialin , e vërtetë që unë kam qenë ai por edhe të tjerët që kam kundërshtuar punët në memorial që ka zgjatur punët më shumë se që 5 vite. Nëse ne mendojmë një projekt kapital për Istogun me afër 1 milion euro dhe duhen 5 vite për tu realizuar dhe ai që mendon se është mirë e ka gabim. Ai projekt ka shkuar për 5 vite dhe më në fund unë i thash kryetarit por nuk mu përgjigj dhe ajo është çështje e tij, kur do të kryhet dhe sa mjete janë harxhuar në atë projekt, se kemi bërë diçka që dikujt mund t'i pëlqejë por ndoshta dikujt jo dhe ka mundur të bëhet me më pak mjete dhe tjetër diçka më mirë dhe çdoherë ne duhet ta bëjmë politizim dhe t'i diskutojmë çështjet, të cilat mendojmë që nuk janë në rregull por ai që sjell vendime është kryetari dhe le te din që edhe nëse janë vendimet e këqija përgjegjësia bie mbi ata që i bien vendimet, faleminderit.

Kryesuesi- falënderon Arif Elshanin dhe fjalën e merr kryetari për replikë.

Kryetari- i përgjigjet Arif Elshanit që ajo kryhet në fund të muajit qershor përfundon kontrata kurse në atë sa mjete janë shpenzuar nuk e di përmendsh por atë informacion mund ta keni kur të doni, sa janë shpenzuar ajo është diçka transparente dhe mund ta keni kur te doni dhe në replikë me Arif Elshanin ia bën me dije që ajo është një e drejtë ligjore për të marrë informacion sipas transparencës dhe i drejtohet Naim Imerajt që nuk është menduar 1 ditë për 4 vite, për këtë është menduar gjatë për të gjitha këto. Shtatoren e presidentit Rugova në qendër të Istogut kemi pas mundësi ta bëjmë me hua, me para te grumbulluara nga bizneset dhe qytetarët që jetojnë jashtë, sigurisht që po, pesëfishin e tyre , të jeni te sigurt por nuk besoj që për presidentin Rugova dhe në këtë rast Fadil Feratin të bëhen memoriale dhe shenja të tilla përmes huave. Kjo duhet të bëhet me taksa të qytetareve një çështje që asnjëherë nuk është përmend sheshin e gjakut. Shumë prej juve e keni në memorie kur pas lufte digjej kulla dhe ai ishte një objekt krimi holokausti me një

fjalë dhe qeveria e përkohshme e asaj kohe në mënyrën më të vrazhdë lejoi që ajo të shkatërrohej pastaj ajo u djeg dhe u rrënuar kur për të ka qene nevoja të merret një vendim sipas të cilit ajo duhej të ruhej dhe kultivohej dhe të bëhej shenjë-simbol memoriali, të përkujtohen krimet që janë bërë nga regjimi i asaj kohe, ndaj popullit jo vetëm të Istogut por të krejt Kosovës. Aty janë masakruar me qindra njerëz dhe kjo nuk duhet të mbetet në harresë për gjeneratat e ardhshme, kjo duhet të jetë e freskët çdo ditë në memorie. Trashëgimia kulturore memoriale historike, objektet e karakterit të tillë sigurisht që kanë edhe karakter zhvillimor dhe avancues në kuptimin e afirmimit të vlerave. Jo vetëm të Istogut por edhe të popullit dhe shtetit në tërësi.

Kryesuesi- falënderon kryetarin dhe fjalën ia kalon Labinot Alijajt.

Labinot Alijaj - pyet kryetarin sa kënde të lojërave për fëmije janë në qytetin e Istogut, nga taksat e qytetarëve dhe pyetja tjetër është në vendin ku është djegur kulla kush ka lejuar të bëhet asfaltimi në atë pjese, nuk e kam lejuar unë por e ke lejuar ti kryetar. Sa iu ke ofruar t'i familjeve që jetojnë në Istog. Po i kërkon 120 mijë euro për ndërtimin e busteve atëherë pyetja ime për ty është sa kënde të lojërave për fëmije ka në Istog nga taksat tona, nga taksat e qytetarëve.

Kryesuesi- merr fjalën kryesuesi dhe atë ia kalon Agron Avdijajt.

Agron Avdijaj- parimisht ne nuk jemi kundër këtyre memorialëve. Si prioritet konsideroi çështjen e stacionit të autobusëve e cila është emergjente, ku stacioni i autobusëve është në një situatë emergjente. Pastaj janë projektet e nevojshme dhe projektet e dëshirueshme. Të analizohet më mirë se cilat janë projekte me emergjente Faleminderit.

Kryesuesi - falënderon Agron Avdijaj për fjalën. Fjalën e kërkon Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- Përshëndet të pranishmit kryetarin, kryesuesin. Po e shoh diskutim të tepërt për sheshin e gjakut, sepse aty janë djegur njerëzit. E përkrah mendimin e kryetarit dhe jam që këto tri projekte të kalojnë. Arsyeja është që të gjitha janë të arsyeshme sidomos ngritja e pllakës për ish kryetarin, sheshi i gjakut, që të gjithë e din historinë e në veçanti unë i takoj atij profesioni.

Kryesuesi- e falënderon Naim Behlulaj dhe fjalën ia kalon Ajshe Metajt.

Ajshe Metaj- Përshëndet të pranishmit, përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së dhe anëtarët e kuvendit. Sa i përket investimit për në sheshin e gjakut është bërë vonë dhe nuk duhet të diskutohet, sepse aty është një histori shumë e hidhur, nuk do të ishte e mirë të mos investohej në atë drejtim duke marr parasysh një të kaluar të përgjakshme. Po ashtu nuk diskutohet as çështja e ndërtimit të pllakës përkujtimore të ish kryetarit të komunës dhe kjo pllakë është e domosdoshme duke e ditur se është kryetari i parë i pasluftës, njëkohësisht edhe për memorialin Ibrahim Rugova

ka çaluar projekti ku kryetari i paraqiti disa arsye dhe mendoj që nuk duhet të diskutohet edhe ajo dhe figura e Ibrahim Rugoves, do të jetë një simbol i mirë aty. Kam një propozim që më pëlqeu shumë, të Arif Elshanit, lidhur me veprimtarin Shaban Manaj i cili e meriton të ketë një shenjë apo simbol në këtë drejtim dhe kjo ide është shumë e mire. Faleminderit

Kryesuesi- falenderon Ajshe Metaj. Fjalën e kërkon Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Lulzim Shoshi.

Lulzim Shoshi- Përshëndet kryetarin dhe të pranishmit. Po flas në emër të kryetarit të PDK-së në Istog dhe jo të drejtorit të bujqësisë. Planifikimi për bartjen e mjeteve është bërë pas konsultimit të përbashkët që e kemi pas duke e marr parasysh koalicionin. Kam pritur që do të bëni pyetje dhe vërejte lidhur me këto memoriale. Me kryetarin Rugova kemi diskutuar së bashku lidhur me përmendoren e UÇK-së e cila nuk është në nivelin e duhur dhe shumë shpejtë do të zgjidhim kontestin pronësor aty dhe në të ardhmen aty do të ngritet një lapidar madhështor i cili do të jetë pjesë e rregullimit të një sheshi. Krahës memorialit Ibrahim Rugova përballë do të kemi një përmendore madhështore të dëshmorëve të kombit. Të gjitha diskutimet e bëra lidhur me këto memoriale i bëjnë nder qytetit dhe të gjithë qytetarëve të Istogut, faleminderit.

Kryesuesi- falënderon Lulzim Shoshin për fjalën. Ky propozim-vendim për riidentifikimin e mjeteve është rekomandim edhe i KPF-s dhe e hedh në votim.

Kuvendi me votim 21 për, 1 votë kundër dhe 5 abstenime miratoi Propozim-Vendimin për miratimi i destinimit të mjeteve të bartura nga viti 2017-2018 në vitin 2019-të

Shqyrtimi i pikës 7

Kryesuesi-vazhdon me shqyrtimin dhe miratimin e pikës së shtatë sipas rendit të ditës, Propozim-Vendimin e Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e rrugës në njësitë kadastrale Nr: 714/4, 714/6, 714/7, 715/8 në Planin Strategjik Urban të Komunës, lidhur me këtë pikë kryesuesi fton drejtorin e drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Urban dhe Hapësinor, Besart Dreshaj.

Besart Dreshaj- falenderon kryesuesin dhe përshëndet, drejtorët, anëtarët e kuvendit, KFOR-in, OSBE-në dhe përfaqësuesit e mediave. Ashtu siç iu tha edhe kryetari në rendin e ditës edhe në komitetin për politikë dhe financa e kemi pas vendimin për largimin apo shfuqizimin e një pjese të rrugës së paraparë me planin urbanistik të vitit 2010 -2018. Kjo rrugë gjendet mbrapa viva fresh-it konkretisht. Kjo rrugë është pronë private, mirëpo me planin urban të vitit 2010 ishte paraparë të

shndërrohet në rrugë publike dhe të kompensohet kjo pjesë e rrugës. Në bazë të ekspertëve të zyrës së urbanizmit dhe njëkohësisht në bazë të kompanisë që është duke i bërë këto ndryshime, planet zhvillimore, harta zonale dhe planin urbanistik, shihet që kjo rrugë më nuk e ka rëndësinë e interesit publik dhe nuk kemi nevojë të bëjmë shpronësimin me vlerat marramendëse për të cilat me hapë këtë rrugë na duhet një vlerë mbi 500 mijë euro, në të cilën janë edhe dy shtëpi. Do të thotë bëhet fjalë për pronë private, të cilën kemi ardhur në përfundimin që duhet të tërhiqemi nga ajo rrugë që është e parapare me planin urbanistik. Pronarët e atyre pronave private kanë bërë kërkesë për shpronësim dhe kanë marr një përgjigje negative nga zyra pronësore-juridike, drejtoria për kadastrë, për shkak se komuna nuk ka mjete për shpronësimin e kësaj rrugë. Kemi ardhur në përfundimin për heqjen e asaj rrugë nga plani rregullues urbanistik dhe kjo mund të bëhet e mundur vetëm nëse ky propozim vendim miratohet nga ana juaj si anëtarë të kuvendit.

Kryesuesi- e falenderon Besart Dreshajn dhe fjalën ia kalon Naim Imerajt.

Naim Imeraj – duke pas parasysh se kur është bërë plani urbanistik i fundit dhe ato ide kanë qenë futuriste në atë kuptimin jo megaloman por në kuptimin e së ardhmes, probleme të tilla kemi shumë në Istog, ajo çfarë unë po kërkoj është se ku është efekti juridik i kësaj, pse kjo çështje është ngritur tash, për t'iu përgjigjur kërkesës së investitorit, kjo do të jetë e qartë për neve. Janë lëshuar rrugë, nuk i ka kontestuar askush, pronarët nuk kanë qenë aty, janë lëshuar rrugë nëpër prona private, kemi plot raste. Dua ta di efektin juridik të këtij vendimi dhe pse një vendim i tillë është sot në kuvend, çfarë e ka iniciuar këtë që ne të marrim vendim, a është diçka e domosdoshme që të mos ketë pasoja juridike administrata, përkatësisht Komuna e Istogut, sepse të rrëzohen dy shtëpi në prona private, për projektin e bërë në vitin 2010 siç ka thënë do të ishte mirë të ishte një rrugë aty. Unë ashtu po e kuptoj

Kryesuesi- fjalën ia kalon Besart Dreshajt për replikë.

Besart Dreshaj – Naim pajtohem me juve, ne kemi probleme edhe tjera si komunë, nuk është vetëm ky problem, në aspektin ligjor ne i kemi kthyer përgjigjen palës i cili ka kërkuar shpronësimin e rrugës ose t'ia lirojmë atë rrugë dhe ai të vazhdoi me ndërtim. Ndërsa ne si komunë dhe ekspertët e urbanizmit së bashku edhe me kompaninë e cila është duke e bërë ndryshimin, kemi ardhur në përfundimin se kjo rrugë më nuk e ka rëndësinë dhe vlerën që të shkohet për të me procedurë të shpronësimit pasi që lidhet me pjesë tjera të rrugës, ne jemi duke punuar edhe me rastet tjera, problemet që i kemi disa lumenjë në Komunën e Istogut e pikërisht në qendër të cilët nuk ekzistojnë më si lumenjë por na kanë mbetur në letër dhe procedura të cilat po na e sjellin probleme dhe po e bllokojnë në njëfarë mënyre impulsin e zhvillimeve të Komunës së Istogut e konkretisht qytetin e Istogut. Me ekspert shumë shpejtë do fillojmë procedurën për t'i shfuqizuar vijat ku është e parapare me njësi kadastrale dhe ata lumenjë të cilët veç po na sjellin probleme

kështu që në aspektin ligjor ne duhet të japim një përgjigje dhe besoj që sot se bashku me juve për interesin e komunës të marrim një vendim sëbashku këtu.

Do të thotë i keni dy opsione. Ne si urbanizëm me kompani të eksperteve kemi ardhur në përfundim që kjo rrugë nuk e ka vlerën dhe nuk është pike strategjike për komunën edhe për interesin tonë edhe për planin zhvillimor pasi që ka qasje në rrugët tjera, faleminderit.

Kryesuesi- fjalën ia kalon, Naim Imerajt.

Naim Imeraj— çështja e rrugës , parcela, planifikimi hapësinor i asaj parcele, në aspektin e ndërtimit, etazhiteti a nuk është çështje e jona, nuk është çështje e kuvendit komunal, nuk na intereson fare, është çështje e juaja që i përgjigjeni ligjit përkatës në aspektin e asaj që jepni një leje ndërtimi që në aspektin urbanistik ka planifikim të etazhitet a jo, ai po deklarohej ose të lëshohet rruga ose t'i jepet leja e ndërtimit, a mos është ndonjë shantazh i vogël në aspektin e asaj që ajo parcelë nuk e ka etazhitetin e caktuar.

Besart Dreshaj- ne asgjë nuk po ndryshojmë me planin urbanistik, as në ndryshimin e kateve por vetëm jemi duke e bërë shfuqizimin apo largimin e rrugës, ne si komunë dhe ekspertët e kanë vlerësuar që nuk është e rëndësishme më ajo rrugë të jetë në pjesën e planit urbanistik, faleminderit.

Kryesuesi- falenderon Besart Dreshajn. Fjalën ia kalon Arben Kabashit.

Arben Kabashi- megjithëse unë e mora përgjigjen sepse ka qenë ajo e planifikuar, jo në planin rregullues urban të komunës por thjesht në planin zhvillimor komunal, atëherë me intereso i përgjigja që e mora, a është interes i komunës që ka bërë kërkesën për këtë ndërrim apo është interesi i personave privat të atyre parcelave.

Kryetari- ua ben me dije anëtareve të kuvendit që do të kemi raste më të shpeshta që do të shqyrtohen sikur ky rast, ku rrugë të ndryshme sipas planit rregullativ urban, në përputhje me procedurat ligjore për shpronësime. Kurse lidhur me pyetjen e anëtarit të kuvendit, Arben Kabashi, iu shpjegua se kjo është në interesin e investitorit, komunës dhe vet qytetarëve.

Kryesuesi- e hedh në votim Propozim-Vendimin e Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e rrugës në njësitë kadastrale Nr: 714/4, 714/6, 714/7, 715/8 në Planin Strategjik Urban të Komunës ku dhe kemi.

Kuvendi me votim unanim, asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim miratoi Propozim-Vendimin e Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e rrugës në njësitë kadastrale Nr: 714/4, 714/6, 714/7, 715/8 në Planin Strategjik Urban të Komunës.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë tre anëtarë Lavdiqe Bujupi, Arif Elshani dhe Radoš Repanović të cilët nuk ishin të pranishëm në këtë seancë.

Kryesuesi- pas marrjes së sugjerimit nga ana e Besart Dreshajt shpjegoi se duhet bere ndryshim i vendimit për shkak të një gabimi të lëshuar në propozim vendimin për ndryshimin e planit rregullues urban, përkatësisht sipas këtij ndryshimi rruga e planifikuar kalon në Njësitë Kadastrale: 714/6, 714/7, 720/4, 720/6 dhe 724/14, Zona Kadastrale- Istog.

Shqyrtimi i pikës 8

Kryesuesi- vazhdon me shqyrtimin dhe miratimin e rishqyrtimit të Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha. Kjo rregullore ka kaluar në diskutim publik dhe në komisionin për politikë dhe financa. Është përcjellë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal-MAPL për konfirmimin e ligjshmërisë ku janë paraqitur tri vërejte që do të na shpjegoj me ne detale drejtori Hysni Maxharraj, cilat janë më tepër vërejte teknike e të cilat janë përmirësuar e që sot janë të gatshme para neve për miratimin e këtyre ndryshimeve.

Hysni Maxharraj- bënë prezantimin e rekomandimeve nga MAPL sipas të cilave duhet bërë ndryshimet përkatëse në Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha.

Kryesuesi- falënderon drejtorin për prezantimin dhe pyet anëtarët e kuvendit se a dëshiron dikush të marr fjalën lidhur me këtë pikë. Fjalën ia kalon Arben Kabashi.

Arben Kabashi- edhe pse rregullorja është thuar se njëjtë sikurse vitin e kaluar, unë e kam një propozim të cmimorja e pagesave të shërbimeve në qendrën sociale. Kërkoj që certifikata shëndetësore për edukim dhe shkollim të zbritet nga 10 euro në 2 euro. Tarifa prej 10 eurove është e lartë për të rinjtë që e nxjerrin këtë certifikatë.

Kryesuesi- e falënderon për propozimin dhe i tregon se për shkaqe juridike është problem dhe po i përmirësojmë vërejtjet e dhëna nga ministria nuk mund ta ndryshojmë atë që e kemi aprovuar sepse kjo na shkakton telashe, tash kemi mundësi t'i rishqyrtojmë vetëm vërejtjet nga MAPL-ja dhe nuk mund të lëshohemi në propozime të reja me dallim prej asaj që kemi votuar më herët. Kërkoj që procedurat për këtë rregullore të fillojnë më herët dhe në muajin shtator kur aprovohet buxheti, të jetë e aprovuar dhe e gatshme për vitin e ardhshëm.

Arben Kabashi- unë pajtohem me ju kryesues

Kryesuesi- e hedh në votim Shqyrtimin dhe miratimin e rishqyrtimit për të Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha

Kuvendi miratoi unanimitet, me asnjë votë kundër dhe 2 abstenime Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë tre anëtarë Lavdije Bujupi, Arif Elshani dhe Radoš Repanović të cilët nuk ishin të pranishëm në këtë seancë.

Shqyrtimi i pikës 9

Kryesuesi- vazhdon me pikën e shqyrtimi dhe miratimit të Rregullore Komunalet për ndarjen e bursave e cila ka kaluar përmes Komitetit për Politikë dhe Financa dhe rekomandimet në të . Lidhur me këtë pikë fton Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, Hajrush Shoshi që të elaboron me tepër këtë Rregullore.

Hajrush Shoshi- përshëndet kryesuesin, drejtorët dhe të gjithë të pranishmit. Prezanton Draft- Rregulloren për ndarjen e bursave e cila nuk ka ndryshime të mëdha prej vitit të kaluar. Si pikë e ndryshueshme vlen të ceket se komisioni ka larguar universitetet private dhe se studentët e këtyre kolegjeve nuk mund të jenë përfitues të kësaj burse, e kemi zbritur shumë mujore të bursës, prej 60 në 45 euro, kjo ka ndodhur për shkak se është ulur çmimi për menzë e konvikte në 30 euro e jo sa ishte më parë 60 deri në 70 euro.

Kryesuesi- falënderon Hajrush Shoshin. Lidhur me Rregulloren hap diskutimin dhe është lajmëruar ta marr fjalën Zenel Shatri dhe Mirushe Sadikaj.

Zenel Shatri- Përshëndet të pranishmit, dhe përmend disa propozime që ka bërë KPF. Paraqet disa shkelje që janë bërë sipas tij gjatë përpilimit të kësaj rregulloreje. Heqja e universiteteve private është diçka e paarsyeshme dhe se komisioni për akreditimin e fakulteteve private dhe të shtetit është i njëjti prandaj është diskriminim heqja e universiteteve private me arsyetimin se ata kanë boll, sipas meje nuk ekziston dhe duhet të konkurrojnë edhe studentët e kolegjeve private dhe po me duket që nuk po e respektojmë hierarkinë e shtetit tonë.

Kryesuesi- pyet Zenel Shatrin se për cilin nen është fjala.

Zenel Shatri- sipas sqarimit i tregon kryesuesit që është fjala për nenin 1. Neni 2 ka vërejtje në kushtet e aplikimit, neni 6 pika 1.5, është për heqjen e mesatares 7.5 me rastin e aplikimit të studenteve për bursë dhe këtë e arsyeton me fakultet më të vështira si drejtime p.sh. fakulteti i matematikës pra të hiqet kriteri i notës mesatare për aplikim, propozimi i tretë, studentet pa të dy prindërit që vlerësohen me 10 pikë

janë pak dhe sipas meje duhet të vlerësohen me 15 pikë kurse studentët që kanë vetëm njërin prind të vlerësohen me 10 pike, neni 7 pika 1.8.

Kryesuesi- e dëgjuam Zenel Shatrin me tri propozime. Sipas rregullores së punës së kuvendit duhet të debatojmë rreth këtyre propozimeve pa filluar debat tjetër pasi të mbarohet punë me to atëherë mund të diskutohet për propozime tjera. Fjalën ia kalon Mirushe Sadikajt dhe Naim Imerajt.

Mirushe Sadikaj – Falënderon kryesuesin, përshëndet drejtorët, asamblastët. Nëse përfshihen fakultet private mendoj që si kriter për aplikimin duhet të përfshihet nota mesatare mbi 8. Neni 6 pika 1.5 mos të hiqet nota mesatare. Ka plot studentë të mire që për shkaqe financiare nuk kanë pasur mundësi t'i vazhdojnë studimet.

Kryesuesi—i drejtohet Mirushe Sadikajt, pra, iu jeni që nota mesatare të mbetet ashtu siç është si kriter për aplikim.

Mirushe Sadikaj- bursa mos të ulet në 45 Euro por të jetë 60 euro si propozim i ri. Te neni 3 pika 3. Siç dihet janë ulur shpenzimet për studente por është ngritur çmimi i rrugës. Dy gabime teknike që po përcillen vazhdimisht është neni 5 pika 3 ku në kllapa është e shënuar afati 15 ditë ndërsa jashtë atyre është 30. Neni 9 pika 1 afati ligjor prej 30 ditë i cili në kllapa është 45 ditë dhe duhet të jetë 30 ditë.

Kryesuesi- fjalën ia kalon Naim Imerajt, Agron Avdijajt, Haki Podrimaj, Labonit Alijajt dhe Ajshe Metajt.

Naim Imeraj- diçka duhet të kemi të qartë. Në Kosovë nuk ka fakultete e as universitete private, ka kolegje private dhe nuk është ekuivalenca e njëjtë, e dyta parimisht jam kundër asaj që fondet publike të shkojnë në kolegje private por edhe në lëmine e shëndetësisë fondet publike të shkojnë në institucionet private.

Kryesuesi- e falënderon Naim Imerajn dhe fjalën ia kalon Agron Avdijajt.

Agron Avdijaj- derisa kolegjet janë të akredituara nga Ministria e Arsimit për arsim të lartë parimisht ish dasht me kanë për, të jetë pjesë e kësaj rregulloreje, në anën tjetër të kriteret e vlerësimit të nota mesatare i ka dy anë. Të hiqet krejt është problematike sepse përfitues më së shumti do të jenë studentët e kolegjeve private. Në anën tjetër nuk e di sa është ligjore që për studentët e kolegjeve private nota mesatare të jetë më lartë, kurse për studentët e universiteteve publike të jetë më ulët.

Kryesuesi- Agron nuk lejohet një gjë e tillë ligjërisht dhe fjalën ia kalon Zenel Shatrit.

Zenel Shatri- Kriter për ndarjen e bursave nuk hyn nota mesatare dhe është e drejtë kjo gjë sepse nëse do të ekzistonte ky kriter për ndarjen e bursave atëherë kolegjet

private i kanë notat më të larta dhe privilegjojen, kurse kriteri për aplikim mendoj se duhet te hiqet.

Kryesuesi- fjalën ia kalon Haki Podrimajt pastaj Ajshe Metajt dhe Eliot Kukiqit.

Haki Podrimaj- Përshëndet të pranishmit. Për çdo ndryshim të bërë të përpunohet një pasues për arsyeshmërinë e ndryshimeve të bëra, ta kemi më të qartë për çka po bëhet fjale. Sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 24 barazia para ligjit neni 1 thotë: pika 1 të gjithë janë të barabartë para ligjit, çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes ligjore pa diskriminim dhe mos jemi duke i diskriminuar në kolegjet private dhe fëmijët tonë që janë pjesë e tyre.

Kryesuesi- Falënderon Haki Podrimajn dhe fjalën ia kalon Ajshe Metajt.

Ajshe Metaj- Përshëndet të pranishmit. E ka një pyetje drejtuar drejtorit Hajrush Shoshi se kush e harton këtë rregullore dhe a konsultoheni me jurist apo jo rreth kësaj. Nëse rregulloren e bën vetë drejtori apo stafi i tij ka mundësi t'i bëj ndryshimet dhe pjesë e saj të jenë edhe kolegjet private, nëse jo çka mund të ndikojmë në këtë. Jam kundër heqjes së notës mesatare sepse nëse eliminohet nota mesatare do të hiqet edhe cilësia dhe ne jemi duke provuar të prodhojmë cilësi. Faleminderit.

Kryesuesi- Falënderon Ajshe Metajn dhe fjalën ia kalon Naim Behlulajt.

Naim Behlulaj- te neni 3 propozoi që shuma mujore e bursës të jetë 50 euro të cilën e kam si propozim. 30 euro kushton menza dhe konvikti dhe 20 euro iu mbetin për rrugë. Faleminderit.

Kryesuesi- fjalën ia kalon Eliot Kukiqit dhe pastaj Labinot Alijajt

Eliot Kukiqi- përshëndet të pranishmit dhe ka një pyetje për drejtorin ku ka dhënë një rekomandim edhe në KPF. Sipas ligjit për vlerat e luftës aty ceket që familjet e dëshmoreve dhe invalidët të UÇK-së në mënyrë direkte e përfitojnë bursën. A e kanë lexuar ligjin në këtë pjesë lejohet diçka e tillë.

Kryesuesi- falënderon Eliotin dhe fjalën ia kalon Labinot Alijajt dhe Hajrush Shoshit.

Hajrush Shoshi- rreth nenit 1 mund të mbetin ose të hiqen kolegjet private unë nuk kam ndonjë vërejtje. Ky nuk është ligj por një rregullore komunale. Mundësitë tona për ndarjen e bursave janë të limituara. Vetëm vitin e kaluar 8 përfitues të bursave nuk kanë mundur të vazhdojnë marrjen e bursës sepse e kanë humbur kushtin për ta vazhduar atë e pikërisht për shkak që nuk ka qenë e paraparë nota mesatare në e

kemi vendose notën mesatare në mënyrë që mos te kenë mundësi të aplikojnë ata studentë të cilët nuk mund të kenë mundësi t'i vazhdojnë studimet, pajtohem që shuma e bursës të jetë 50 euro. Si pikë tjetër me të cilën pajtohem është që studentet të cilët nuk i kanë të 2 prindërit të vlerësohen me 15 pikë. Është formuar komisioni për Rregulloren e ndarjes se bursave pjese e së cilës janë edhe 2 juristë dhe gjithsej në këtë komision janë 7 anëtarë. Kategorikisht jam që të mbetet nota mesatare, jam për zbritje por jo edhe për heqje.

Labinot Alijaj- diskuton rreth nenit 7 pika 8, studentët pa te dy prindërit vlerësohen me 10 pikë, kurse studentët vetëm me njërin prind të vlerësohen me 5 pikë dhe unë jam për rastet kur nëna është kryefamiljare studentët të vlerësohen me 10 pikë. Pra kur nëna është kryefamiljare.

Kryesuesi- fjalën ia kalon Agron Avdijaj.

Agron Avdijaj- neni 7 pika 1.4 familjet me asistencë sociale të vlerësohen më shumë pikë. Prej 10 ne 15.

Kryesuesi- ne jemi që të iu ndihmojmë familjeve me asistencë sociale por duhet t'i kemi parasysh edhe lëmitë deficitare. Fjalën ia kalon Muhamet Ukajt dhe Hajrush Shoshit.

Hajrush Shohi- te studentët me asistencë sociale të cilët vlerësohen me 10 pikë automatikisht marrin edhe 10 pike tjera që nuk e kanë asnjë të punësuar dhe këtyre iu behën 20 pikë që në fillim.

Muhamet Ukaj- edhe unë e përkrahi idenë që shuma e bursës të jetë 50 euro dhe të mbetet nota mesatare si kriter i aplikimit.

Kryesuesi- e falënderon Muhamet Ukajn. I hedh në votime propozimet e bëra. Neni 1, propozimi është që të shtohen edhe kolegjet private. Pyet anëtarët e kuvendit se kush është që në këtë nen të shtohen edhe kolegjet private.

Sipas këtij votimi 11 janë për, 10 kundër dhe 2 abstenime. Mungon edhe një asamblist dhe përsëritet Votimi për shkak të mospërputhjes se votave sepse janë ne total 23 vota, kurse prezent i kemi 24 asambleistë.

Sipas votimit të dytë kemi 11 vota për, 11 kundër dhe 2 abstenime. Ne sallë janë 24 anëtarë të kuvendit atëherë përfundojmë se neni 1 mbetet në rregullore ashtu siç është fal votës se kryesuesit të kuvendit.

Në procedurën e votimit nuk morën pjesë tre anëtarë Lavdiqe Bujupi, Arif Elshani dhe Radoš Repanović të cilët nuk ishin të pranishëm në këtë seancë.

Kryesuesi- Vazhdon procedimin me nenin 3 pika 3 përkatësisht propozimin që shuma e bursës nga 45 të jetë 60 euro dhe e hedh në votim por fjalën kërkon ta marrë Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- asnjë komunë në Kosovë nuk e ka 60 euro shumën mujore të bursës, ka që e ndajnë në forma të ndryshme p.sh. Peja e ndan vetëm për matematicientë dhe nuk i shikojnë kriteret duke ua dhënë nga 2 mijë euro në vit, ka komuna që i japin në forme të subvencioneve dhe askund nuk ka mbi 50 euro e cila mbulon menzen, konviktin dhe 2 vajtje ardhje.

Zenel Shatri- edhe unë jam që shuma e bursës të jetë 50 euro ashtu që të rritet numri i bursistëve.

Mirushe Sadikaj- nga kjo shumë e bursës prej 50 euro vetëm një herë e gjysme kanë mundësi të udhëtojnë studentët dhe nuk pajtohem që kjo shumë të jetë 50 euro.

Kryesuesi- e hedh prapë në votim propozimin që shuma e bursës nga 45 të jetë 50 euro.

Sipas këtij votimi kemi: unanimitet votohet në shumën prej 50 eurove (21 vota për) asnjë kundër dhe 3 abstenime dhe ky propozim kalon.

Kryesuesi- vazhdon procedimin me nenin 6 pika 1.5. propozimi ishte që mesatarja 7.5 për studentë përkatësisht 4.5 për nxënës të hiqet si kriter i aplikimit si dhe rekomandim i KPF-së. Kryesuesi pyet propozuesin që nota mesatare 7.5 a mbetet si kriter vlerësues për ndarjen e bursave apo hiqet.

Zenel Shatri- Deklaron se të kriteret e ndarjes së bursave nuk ekziston mesatarja 7.5 dhe ajo është vetëm të kriteret e aplikimit dhe unë jam që kjo mesatare të hiqet si kriter i aplikimit por jo edhe i vlerësimit.

Kryesuesi- është i pajtimit që mesatarja 7.5 të hiqet si kriter i aplikimit dhe të mbetet si kriter vetëm në vlerësim. Fjalën ia kalon Hajrush Shoshit.

Hajrush Shoshi- nëse e heqim mesataren 7.5 në aplikim dhe e lëmë vetëm në vlerësim në vetëm po iu nxjerrim punë dhe shpenzime dhe po i dëmtojmë studentët aplikues në këtë mënyrë dhe kur të vjen momenti i vlerësimit studenti me mesataren nën 7.5 nuk ka asnjë mundësi të kalojë më tutje e të jetë përfitues i bursës dhe kështu

asgjë nuk po iu ofrohet ndihmë me heqjen e mesatares. Nëse hiqet mesatarja ajo duhet të hiqet si nga kriteret e aplikimit ashtu edhe të vlerësimit. Më e arsyeshme është që mesatarja të mbetet si kriter i aplikimit.

Kryesuesi- neni 6 pika 1.5 që të mbetet si kriter i aplikimit mesatarja 7.5. E hedh në votim këtë propozim.

Sipas këtij votimi kemi: 13 vota për, ky propozim kalon dhe mbetet mesatarja 7.5 si kriter i aplikimit.

Kryesuesi- neni 7 pika 1.8. studentët pa të 2 prindërit të vlerësohen me 15 pikë nga 10 sa është tash, kurse studentët vetëm me njërin prind të vlerësohen me 10 pikë.

Sipas këtij votimi kemi: 22 për, 1 kundër dhe 2 abstenime, miratohet ky propozim.

Kryesuesi- e hedh në tërësi për votim aprovimin e draft rregullores për ndarjen e bursave.

Sipas këtij votimi kemi: 21 për, asnjë kundër dhe 2 abstenime, kalon kjo rregullore . 23 anëtarë të kuvendit të pranishëm.

Në procedurën e votimit nuk morën Lavdiqe Bujupi, Arif Elshani, Rados Repanovic dhe Jehonë Haxhiaj të cilët nuk ishin të pranishëm në këtë seancë.

Kryesuesi- kjo rregullore parasheh krijimin e komisionit për ndarjen e bursave dhe komisionin për ankesa. Janë komisione që krijohen për një mandat. E kemi për obligimin në si kuvend që të zgjedhim anëtarët e këtyre komisioneve. Fjalën e kërkon Zenel Shatri dhe kryesuesi ia kalon.

Zenel Shatri- propozoi që në mbledhjen e ardhshme të vijmë me emra të gatshëm të anëtarëve të këtyre komisioneve sipas subjekteve politike.

Kryesuesi- Komisionet janë sipas fuqisë politike por te komisioni për ankesa e kemi pas një anëtare të VV. Në komisionin për ndarjen e bursave partitë politike janë përfaqësuar si në vijim: 1 anëtar nga LDK, 1 anëtar nga AAK dhe 1 anëtar nga PDK. Kurse në komisionin për ankesa 1 nga LDK dhe një nga VV. Fjalën e kërkon Naim Imeraj të cilën ia kalon kryesuesi.

Naim Imeraj- Në mandatin e kaluar të komisionit të ankesave për ndarjen e bursave në si AAK kemi hequr dorë nga e drejta në bazë të përfaqësimit në favor të VV dhe kështu VV kishte një anëtarë në komisionin për ankesa. Pasi që sot po krijojmë komisione të reja, do të vendosim atë që është me e udhës.

Kryesuesi- ua bën me dije anëtarëve të kuvendit që përveç fuqisë politike duhet bërë kujdes edhe në aspektin e barazisë gjinore.

Shqyrtimi i pikës 10

Kryesuesi- vazhdon me këtë pikë, shqyrtimin dhe miratimi i rishqyrtimit të rregullores për hapjen e kutive të ankesave në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Istogut sipas inicimit të drejtorisë së arsimit është krijuar një komision i cili është marrë me hartimin e kësaj rregulloreje dhe kjo rregullore ka kaluar në KPF e cila edhe i ka dhënë rekomandimet e veta. Pyet anëtarët e kuvendit nëse ka dikush ndonjë propozim në këtë draft -rregullore dhe fjalën e kërkon Ajshe Metaj.

Ajshe Metaj- nga shkolla që unë vijë, kutia e ankesave ka qenë që disa vite. Nuk kam informacione për ndonjë rast të raportuar, jam që të ketë kuti të ankesave por komisioni të punojë në mënyrë sa më objektive, të dihen nga kush vijnë ato ankesa sepse ato mund të vijnë vetëm me qëllimin që t'ia humbin imazhin dikujt por unë jam për kutitë e ankesave dhe shpresoj që të funksioni si duhet.

Kryesuesi- fjalën e kërkon Arben Kabashi të cilën ia kalon kryesuesi.

Arben Kabashi- kjo rregullore do të dalë në diskutim publik dhe në nuk kemi pse e diskutojmë këtë kaq shumë sepse ajo prapë do të kthehet në kuvend.

Kryesuesi- e hedh në votim që kjo rregullore të shqyrtohet dhe diskutohet me qytetarë fillimisht.

Sipas këtij votimi kemi: unanimisht votohet pro që kjo rregullore të kalojë në shqyrtim publik i cili zgjat 2 javë.

Kryesuesi- pas shqyrtimit në publik kjo rregullore do të kthehet në KPF dhe në kuvend për miratim.

Shqyrtimi i pikës 11

Kryesuesi- shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit të Kryetarit të Komunës për formimin e komiteteve konsultative, për arsim, shëndetësi dhe shërbime publike. Propozimi e ka bazën në udhëzimin administrativ Nr. 01-2016 të MAPL-së në të cilin shpjegohet qartë për formimin e këtyre komiteteve konsultative si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Komitetet konsultative përbehen prej 5 deri në 7 anëtarë, kuvendi përcakton numrin e anëtarëve të komiteteve, nëse miratohet

propozim-vendimi i kryetarit të komunës. Kuvendi merr përsipër shpalljen e konkursit si dhe formon panelin për zgjedhës dhe përbërja e komiteteve përcaktohet sipas fuqisë politike. Fjalën e kërkon Naim Imeraj të cilën ia kalon kryesuesi.

Naim Imeraj- një pjesë e madhe e anëtarëve të kuvendit janë edhe nga legjislacioni i kaluar. Në legjislacionin e kaluar e kemi zbatuar një procedurë të tillë dhe krejt ajo ka kaluar që të arrihet diçka. Nuk e di ato komisione a janë mbledhur ndonjëherë të paktën, a ia kanë bërë vetes një rregullore të punës, shpresoi që kjo nismë do të rezultojë në diçka konkrete në të ardhmen pas një pune relativisht të mundimshme, mos të vijë puna që ato komisione as mos të shihen ndërmjet vete pas formimit të tyre shpresoj të ketë rezultate konkrete.

Kryesuesi- nuk mund të përgjigjem në atë se çka ka ndodhur përpara. Nuk është patjetër kjo e cila parashihet në udhëzimin administrativ por vlerësohet shume në performancë dhe është e udhës që t'i formojmë këto komitete po sipas këtij udhëzimi këto komitete paguhen për punën që bëjnë nga kodi buxhetor për paga dhe mëditje në proporcion me komitetet e përhershme (komiteti për politikë dhe financa dhe komiteti për komunitete). Mandati i anëtarëve të komiteteve është 4 vjeçar. Këto komitete kanë për obligim t'i mbajnë 4 deri 6 takime brenda vitit. Fjalën e kërkon Haki Podrimaj të cilën ia kalon kryesuesi.

Haki Podrimaj- me sa e di unë ata që paguhen nga buxheti i shtetit nuk paguhen për punën në këto komitete.

Kryesuesi- po e vërtetë është kjo. Anëtarët e kuvendit nuk kanë të drejtë të jenë anëtarë të këtyre komiteteve konsultative. Fjalën e kërkon Ajshe Metaj të cilën ia kalon kryesuesi.

Ajshe Metaj- jemi për formimin e këtyre komiteteve por jo vetëm në letër siç ishte deri me tash, shpresoj që në përbërje të këtyre komiteteve të ketë njerëz me eminent dhe këto komitete të funksionojnë, faleminderit.

Kryesuesi- ne po i themelojmë këto komitete me qëllim të funksionimit, e hedh në votim miratimin e këtyre.

Sipas këtij votimi kemi: votohet unanimisht për , asnjë vote kundër, asnjë votë abstenim, në sallë të pranishëm 19 anëtarë.

Kryesuesi- konstatohet se miratohet propozim vendimi i kryetarit të komunës për formimin e këtyre komiteteve konsultative. Pyet anëtarët e kuvendit se a janë që këto komitete t'i kenë 5 apo 7 anëtarë. Haki Podrimaj e kërkon fjalën të cilën ia kalon kryesuesi.

Haki Podrimaj- propozon qe t'i kenë 5 anëtarë.

Kryesuesi- kush është që komitetet konsultative të përbëhen nga 5 anëtarë, e hedh ne votim.

Unanimisht aprovet qe komitetet t'i kenë 5 anëtarë.

Kryesuesi- kuvendi formon panelin përzgjedhës me 3 anëtarë nga kuvendi, 1 anëtar nga ekzekutivi dhe një anëtar nga shoqëria civile. Kryesuesi iu drejtohet anëtarëve të kuvendit për krijimin e paneleve përzgjedhëse. 3 komisione me nga 3 anëtarë. Komiteti për arsim: Naim Behlulaj LDK, Muhamet Ukaj AAK, Ajshe Metaj PDK. Komiteti për shëndetësi: Zenel Shatri LDK, Eliot Kukiqi AAK, Mirushe Sadikaj PDK. Komiteti për shërbime publike: Valbona Demaj LDK, Nexhmedin Balaj AAK, Arben Kabashi PDK.

I hedh për votime këto panele përzgjedhëse për komitetet konsultative.

Unanimisht votohet pro për të gjitha komitetet konsultative.

Shqyrtimi i pikës 12

Kryesuesi- pyetje nga anëtarët e kuvendit, Agron Avdijaj ka ngritur një shqetësim për çështjen e autostradës, kryesuesi i përgjigjet që kjo është një çështje me tepër e nivelit qendror përkatësisht e Ministrisë së Infrastrukturës. Fjalën ia kalon Agron Avdijajt.

Agron Avdijaj- nuk kemi informacione se çfarë gjatësie do të kaloj autostrada në Komunën e Istogut, sa sipërfaqe merr kjo autostradë dhe në çfarë lloj tokash-pronësishë kalon kjo autostradë, në pronësi shoqërore, pronësi private, në sistemim e ujitjes, pra komuna me e ditë koston rreth kësaj, ky ishte shqetësimi ynë kryesor. A ka komuna informacione, përkatësisht drejtoria e urbanizmit si organ kompetent.

Kryesuesi- jemi në fazën e hartimit të projektit dhe është e pamundur të marrim përgjigje për ato. Fjalën ia kërkon Hajrush Shoshi të cilit ia kalon kryesuesi.

Hajrush Shohi- gjatësia e autostradës është 16.6 km dhe për të do të merren 90 hektarë tokë për autostradë, pasi që nuk është këtu prezent drejtori i urbanizmit ua ofrova unë këtë informacion.

Kryesuesi- fjalën e kërkon Arben Kabashi dhe Haki Podrimaj të cilëve ua kalon kryesuesi.

Arben Kabashi- kërkoi që në mbledhjen e ardhshme të na raportoi komisioni për sigurinë në bashkësi që të na ofrojnë informacione për sferën e sigurisë.

Haki Podrimaj- kam një pyetje për drejtorin për buxhet dhe Financa dhe le të sjell përgjigjen në seancën e ardhshme pasi që ai nuk qenka prezent tash. Anëtarët e paneleve i zgjodhëm por a ka mundësi të dihet a do të paguhen për punën e tyre. Në disa komuna i paguajnë anëtarët e paneleve.

Kryesuesi- Kjo po paraqitet si problem në vazhdimësi e kemi një shkresë sipas të cilës, ata që marrin pagë nga buxheti nuk mund të paguhen, për të tjerët do të shikohet mundësia si do të veprohet dhe a ka mundësi për pagesë, Fjalën e kërkon Naim Imeraj të cilën ia kalon kryesuesi.

Naim Imeraj- po flas sipas një logjike nëse ne si anëtarë të kuvendit paguhemi nga buxheti dhe krejt anëtarët e atyre paneleve i zgjodhëm nga kuvendi e të cilët marrin paga nga buxheti.

Kryesuesi- Akoma nuk kam marr një përgjigje me shkrim për këtë dhe nuk mund të flas asgjë. Fjalën e kërkon Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- siç kam informacion Suhareka dhe Klina i paguajnë të gjitha komitetet pavarësisht a marrin paga nga buxheti apo jo madje edhe komisionet e ndryshme si p.sh. komisioni për ndarjen e bursave dhe komitetet konsultative. Nëse na takon kjo e drejtë ligjore pse mos të realizohet.

Kryesuesi- le të mbetet për takimin e ardhshëm kjo dhe fjalën ia kalon Ajshe Metaj të cilën e kërkuar.

Ajshe Metaj- nga legjislatura e kaluar keni pas me planifiku që disa anëtarë të kuvendit me realizu vizita në ndonjë asamble diku në vendet fqinje, kërkoi që të iniciohet kjo procedurë dhe të bëhet shkëmbimi i përvojave, faleminderit.

Kryesuesi- Nuk kemi akoma ndonjë binjakëzim sepse të realizohet ajo ka telashe dhe këtë nuk mund ta bëj i vetëm, unë e kërkoj edhe ndihmën tuaj po ashtu të administratës komunale dhe të ekzekutivit për të shikuar një mundësi të tillë, e kemi edhe në planin e punës por duhet të analizojmë se si do të veprojmë. Faleminderit për pjesëmarrje, ju uroj mirëseardhje në takimin e ardhshëm.

Mbledhja përfundoi me punë në ora, 13:40

Procesmbajtës,
Faton Bujupi



Kryesues,
Qasht Balaj

